

PARIMET BAZË TË KONTABILITETIT

HYRJE

PARIMET-KONCEPTET BAZË

- **Rregullat për regjistrimin e transaksioneve** ekonomike kanë lind nga **përvojat më të mira që i ka ofruar jeta praktike afariste.**
- **Parimet-konceptet bazë nuk janë asgjë tjetër përpos rregulla të cilat i ka zhvilluar teoria dhe praktika afariste, për të krijuar një metodologji unike të grumbullimit, përpunimit dhe raportimit të t' dhënave që rrjedhin nga transaksionet afariste.**

A. KONCEPTET BAZË MBI TË CILAT BAZOHET BILANCI I GJENDJES

1. Parimi-Koncepti i Masës Monetare
2. Parimi-Koncepti i Entitetit
3. Parimi-Koncepti i vazhdueshmërisë
4. Parimi-Koncepti i Kostos (çmimit kushtues)
5. Parimi-Koncepti i aspektit të dyfishtë

1. Parimi-Koncepti i Masës Monetare

- Organizata varësisht nga lloji i aktivitetit që zhvillon disponon me mjete të caktuara të cilat ndodhën në forma të ndryshme
- Do të ishte shumë vështirë që të përfshihej dhe të paraqitej në librat dhe raportet e kontabilitetit, të krahasohej me organizatat e ngjashme, pa **emëruesin e përbashkët paranë**.

Të metat e parimit të masës monetare

1. Një numër i madh i transaksioneve brenda organizatës që kanë të bëjnë me organizatën nuk mund të përfshihen në kontabilitet.
2. Një e metë tjetër parasë është *vlera kohore e saj*.
3. Një e metë tjetër është e lidhur me *zhvlerësimin e vlerës së parasë si rezultat i inflacionit*.

2. Parimi-Koncepti i Entitetit

- Parimi i entitetit kërkon ***që kontabiliteti të mbahet në mënyrë të ndarë për organizatën si entitet***, dhe se në këto regjistrime të kontabilitetit nuk duhet të përfshihen aktivitetet e pronarit të kapitalit e të cilat nuk kanë të bëjnë me aktivitetet afariste të organizatës.

2. Parimi-Koncepti i Entitetit

- Shembulli nr. 1
- 1). Po të supozojmë se një qytetar vendos të themeloj një organizatë dhe në emër të kapitalit themelues paguan në llogarinë bankare të organizatës 100,000E. Çfarë regjistrimesh do të kemi në kontabilitetin e organizatës?
- Zgjidhje:
- Në këtë rast llogaria bankare e organizatës do të debiton kurse llogaria e kapitalit të pronarit (e cila tregon se nga kanë ardhur paratë) do të krediton.

3. Parimi-Koncepti i vazhdueshmërisë

- Niset nga supozimi se organizata është themeluar **me qëllim të afarizmit të vazhdueshëm**.
- Çmuarja apo vlerësimi **dallon** për entitetet që vazhdojnë nga ato që pushojnë së funksionuar.
- Vlera e organizatës që pushon së ekzistuari duhet të çmohet në momentin e likuidimit **sipas çmimeve likuiduese**.
- Sipas këtij parimi kontabilitetit merret me regjistrimin grumbullimin, përpunimin dhe raportimin e transaksioneve **afariste në momentin e ndodhjes së transaksioneve** pa pasur nevojë që të kthehemi prapa dhe të rivlerësojmë pasurinë.

4. Parimi-Koncepti i Kostos (çmimit kushtues)

- Për të kuptuar konceptin e kostos në kontabilitet është e nevojshme që të kuptojmë së pari **nocionin e pasurisë së organizatës**.
- **Pasuria** paraqet resurset ekonomike me të cilat organizata zhvillon aktivitetin e saj.
- Pasuria monetare **regjistrohet në kontabilitet sipas vlerës së tyre fillestare**, e cila mund të konsiderohet si vlerë reale e tregut.
-
- Pasuria jo monetare zakonisht regjistrohen në kontabilitet **sipas çmimit të paguar për arritjen e tij – në çmimin kushtues të tij**.

5. Parimi-Koncepti i aspektit të dyfishtë

- Pasuria me të cilat zhvillon afarizmin e vet organizata janë të dikujt:
 - të pronarit të organizatës, ose
 - të atyre që përkohësisht ia kanë huazuar organizatës.
- Në këtë mënyrë në kontabilitet ndërtohet **relacioni i dyfishtë**:

$$\text{PASURIA} = \text{DETYRIMET}$$

- Detyrimet mund të jenë
 - detyrime ndaj pronarit të kapitalit dhe
 - detyrime ndaj kreditorëve
- $\text{PASURIA} = \text{DETYRIMET} + \text{KAPITALI I PRONARIT}$

B. KONCEPTET MBI TË CILAT BAZOHET BILANCI I TË ARDHURAVE

1. Parimi-Koncepti i periudhës në kontabilitet
2. Parimi-Koncepti i konzervatizmit (kujdesit) në kontabilitet
3. Parimi-Koncepti i realizimit
4. Parimi-Koncepti i ballafaqimit

1- Parimi-Koncepti i periudhës në kontabilitet

- Themeluesit, aksionaret, menaxherët, shteti dhe të interesuarit e tjerë
 - *janë të interesuar që në intervale kohore më të shkurtra të dinë se si është duke afaruar organizata.*
- Kjo kërkesë ka shpie deri të **shfaqja e konceptit të periudhës në kontabilitet**,
 - i cili nënkupton atë se në periudha të caktuara kohore të konstatohet sukcesi dhe gjendja e organizatës, që zakonisht janë periudha një vjeçare, por mund të jenë edhe më të shkurtra.

2- Parimi-Koncepti i konzervatizmit në kontabilitet

- Ky parim nisët nga parimi i kujdesisë me **rastin e paraqitjes së pozitës financiare të organizatës** si dhe të suksesit të saj.
- Lidhur me të ai nënkupton:
 - se më mirë është të **nënçmohet pasuria** sa herë ekziston dyshimi se një pozicion i caktuar mund të zvogëlohet, dhe se
 - më mirë është të tregohen më të mëdha **detyrimet** sa herë që ekziston dyshimi se ai detyrim është më i madh se sa ai është tani,
 - se më mirë është që të **nënçmohen të hyrat** sa herë se ekziston rreziku se një e hyrë e caktuar vështirë se do të mund të arkëtohet dhe anasjelltas
 - më mirë është që të **tregohen më të mëdha shpenzimet** sa herë që ekziston dyshimi se një shpenzim do të jetë më i madh se sa kemi regjistruar në kontabilitet, se sa ato të nënçmohen.

3 - Parimi-Koncepti i realizimit

- Koncepti i realizimit ka të bëjë me njohjen e të hyrave. Pra kur të hyrat konsiderohen të realizuara? Në momentin e
 - dorëzimit të mallit,
 - kryerjes së shërbimeve apo
 - në momentin e arkëtimit të parave për mallin e dorëzuar dhe shërbimet e kryera.

4. Parimi-Koncepti i ballafaqimit

- Shitja e të mirave dhe shërbimeve gjithmonë është e shoqëruar me dy efekte të kundërta për organizatën, dhe atë:
 - efekti i shpenzimeve për prodhimin dhe shitjen e mallrave e shërbimeve, si dhe
 - efekti i të hyrave si rezultat i shitjes së mallrave dhe shërbimeve.
- Që të matet në mënyrë korrekte efekti neto i shitjes dhe fitimi i mbetur i periudhës, që të dy këto efekte duhet të njihen në të njëjtën periudhë të kontabilitetit kur kanë ndodhur.

C. PARIMET E TJERA BAZË TË KONTABILITETIT TË DYFISHTË

1. Parimi-Koncepti i konsistencës-njëtrajtësisë, vijueshmërisë
2. Parimi-Koncepti i Materialitetit
3. Parimi-koncepti i parave të gatshme
4. Parimi-koncepti rrjedhës (akruar)

1. Parimi-Koncepti i konsistencës-njëtrajtësisë, vijueshmërisë

- Ky parim kërkon që me rastin e regjistrimit dhe raportimit të t' dhënave të kontabilitetit duhet të ekzistoj një vazhdueshmëri e përdorimit të metodave nga një periudhë e kontabilitetit në tjetrën.

1. Parimi-Koncepti i konsistencës-njëtrajtësisë, vijueshmërisë

- Rëndësia e konceptit të konsistencës në kontabilitet ka të bëjë **me krijimin e bazës për krahasimin e të dhënave** dhe raporteve kontabël nga një periudhë në tjetrën.

2. Parimi-Koncepti i Materialitetit

- Parimi apo koncepti i materialitetit në kontabilitet ka të bëjë me rendësin materiale të ndodhive (transaksioneve) të cilat duhet të regjistrohen në kontabilitet
- Parimi i materialitetit lejon që ndodhitë të cilat janë të parëndësishme të mos regjistrohen në momentin e ndodhjes por të njëjtat të grupohen dhe të regjistrohen në periudha të caktuara kohore.

3. Parimi-koncepti i parave të gatshme

- Sipas kësaj metode të hyrat dhe shpenzimet do të regjistroj në kontabilitet vetëm në momentin kur kemi arkëtimi (marrje) dhe pagesa (dhënie) monetare.
- Kjo do të thotë se të hyrat do të regjistrohen jo në momentin kur shiten mallrat dhe shërbimet por në momenti kur ato do të arkëtohen në para.
- Po kështu shpenzimet e periudhës do të regjistrohen si shpenzime në momentin kur të njëjtat do të paguhen në para.
- Kjo metodë nuk merr parasysh parimin e rrjedhës (akruar)

3. Parimi-koncepti i parave të gatshme

- Kjo metodë e kontabilitetit nuk është e zbatueshme për organizata prodhuese dhe shërbyese si dhe **organizatat që shfrytëzojnë mundësin e afarizmit përmes kreditimit.**

4. Parimi-koncepti I kontabilitetit rrjedhës (akrual)

- Parimi rrjedhës kërkon që në kontabilitet t'i regjistrojmë transaksionet në momentin e ndodhjes pa marr parasysh momentin e pagesës apo arkëtimit të parave.
- Kjo do të thotë se të hyrat do t'i regjistrojmë
 - në harmoni me parimin e realizimit në momentin e dorëzimit të mallrave përkatësisht kryerjes së shërbimeve pa marr parasysh se kur do të bëhet arkëtimi i parave.
- Po kështu edhe shpenzimet do t'i regjistrojmë
 - në momentin e ndodhjes së tyre, përkatësisht nga fakti se kur do të bëhet pagesa monetare.